

# Kontratë Dhurimi

Sot më datë 20 /01 /2020 u paraqitën për të lidhur këtë kontratë palët e mëposhtme:

## Palët pjesëmarrëse në kontratë

Dhuruesi Z. **Dhimitraq Andrea** me zotësi të plotë juridike për të vepruar .

Përfituesi Z. **Kanan Proda** me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

## Objekti i Kontratës

Objekti i kësaj kontrate dhurimi i 50% te kuotave të kapitalit të shoqërisë “WORK STEEL” të cilat i përkisnin z. Dhimitraq Andrea , me heqjen dorë vullnetarisht prej tij të shpërndahen në formë të tillë si: 50% të kuotave tek Z. Kanan Proda, duke e kaluar statusin e Z. **Kanan Proda** si pronar i 100% te kuotave te shoqerise “**WORK STEEL**” Sh.p.k NIPT: L81603017C

Palët me marrëveshje midis tyre, me vullnetin e tyre të lirë dhe në përputhje me nenet 761 e vijues të Kodit Civil.

## Vendosën

Të lidhin këtë kontratë në kushtet e mëposhme :

## Qëllimi

### Neni 1

Qëllimi i kësaj kontrate është kalimi pa kundër shpërblim të pronësisë, objekt I kësaj kontrate nga dhuruesi tek përfituesi të cilën ky i fundit e pranon.

## Afati i dorëzimit të pronësisë



## **Neni 2**

Dorëzimi i % së kapitalit do të bëhet menjëherë mbas nënshkrimit të kësaj kontrate.

## **Të drejtat dhe detyrat e dhuruesit**

### **Neni 3**

1. Dhuruesi merr përsipër të garantojë përfituesin për përkatësinë e objektit të kësaj kontrate.
2. Dhuruesi duhet të dorëzojë objektin e kontratës në kohën e përcaktuar sipas nenit 2 të kësaj kontrate.

## **Pranimi i përfituesit**

### **Neni 4**

Pranuesi i objektit të kontratës vendos të pranojë dhurimin.

## **Sanksionet**

### **Neni 5**

Dhuruesi detyrohet të përmbushi detyrimet e parashikuara në këtë kontratë përndryshe përgjigjet sipas dispozitave të Kodit Civil.

## **Shpenzimet e lidhjes së kontratës**

### **Neni 6**

Në marrëveshje midis palëve shpenzimet e lidhjes së kontratës i takojnë përfituesit.

## **Hartimi i Kontratës**

Kjo kontratë u hartua në katër kopje ku një nga to e marin secila nga palët pjesëmarrëse. Pasi u lexua, u nënshkrua nga secili prej tyre në vullnet të plotë e të lirë.


## Lidhja e kontratës

Kjo kontratë do të quhet e lidhur në momentin që do të behet kalimi I të drejtave të % së kuotave tek secili përfitues.

## Palët Kontraktuese

**DHURUESI**

**DHIMITRAQ ANDREA**

*Dhimitraq Andrea*  


**PERFITUES**

**KANAN PRODA**

*Kanan Proda*  
